

URDHER NR. 225 DT 29.06.2004
“PER KRIJIMIN E INSTITUTIT E NDERTIMIT”

Mbeshtetur ne piken 4, neni 102, i Kushtettes se Republikes se Shqiperise dhe nenin 3 te ligjit 7582 dt.13.07.1992 “Per ndermarrjet Shteterore”, i ndryshuar me qellim institucionalizimin e nje strukture per te vazhduar e permiresuar kerkimet, studimet dhe realizimin e objektivave ne fushen e rregullave teknike te projektimit e te zbatimit te puneve publike ne perputhje me euronormat,

URDHEROJ:

1. Krijimin e Institutit te Ndertimit, si rezultat i bashkimit te Instituti i Studimeve te Teknologjise se Ndertimit (ISTN), Instituti i Studimeve e Projektimeve Hidroteknike (ISPH) dhe aktivitetit te ish Instituti i Studimeve e Projektimeve te ujesjelles Ndertime (ISPUN) ne varesi te Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, me seli ne Tirane.
2. Objekti kryesor i punes se institutit te Ndertimit eshte kryerja e veprimtarise kerkimore shkencore, aplikative zhvillimore dhe projektuese ne fushen e ndertimit, si dhe kryerja e veprimtarive shkencore e teknologjike per te trette te tilla si oponenca, ekspertiza, kurse kualifikimi, vleresime konformiteti dhe kontrole per produktet e ndertimit qe lidhen me sigurine e jetes.
3. Organizimi dhe funksionimi i Institutit te Ndertimit do te behet ne perputhje me ligjin nr. 7582 dt.13.07.1992 “Per ndermarrjet Shteterore”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.
4. Ngarkohet Sekretari i pergjithshme dhe Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve per zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

MINISTRI

Bashkim FINO